


Projekti Strategjik **'mat'** Zhvillimi i Integruar i Bashkisë Pogradec

 **Mjedis**
 **Agrobiznes**
 **Turizëm**



**Eduart
KAPRI**



Mes këtij dokumenti strategjik, ju bëjmë të njohur **Projektin tonë të Veprimit për periudhën 2015-2019**, si dhe fushat ku do të fokusohemi për zhvillimin socio-ekonomik të Bashkisë Pogradec, duke synuar një zhvillim të integruar, të shumëtrajshëm dhe të qëndrueshëm, në një terren administrativ që ofron mundësi dhe shanse për gjithësecilin, pa përjashtim, mes një Pushteti Lokal që do të orientojë aktivitetin e tij funksional tek **Partneriteti Publik-Privat**, si boshti kryesor i transformimit të Bashkisë së Pogradecit, në një Bashki me fizionomi europiane.

Bashkia jonë është një prej zonave më të rëndësishme në vend, me një hapësirë gjeo-territoriale heterogjene (liqenore, kodrinore & malore), me pasuri të pashtershme të natyrës, por dhe me një popull vital, punëtor dhe të lidhur ngushtë me trevën në të cilën jeton.

Projekti Strategjik “mat”, një akronim ky i tre fushave kryesore të vëmendjes sonë qeverisëse në katër vitet e ardhshëm: (a) **Mjedis**; (b) **Agrobiznes**; (c) **Turizëm**, është Udhërrëfyesi i punës së Bashkisë në vitet në vijim. Një plan i qartë ndërhyrjesh në territor, një plan i orientuar për të mbështetur sipërmarrjen, një plan që mbështet dhe hap horizontet për përmirësimin dhe konsolidimin e sektorit të Turizmit, një Projekt i mirëplanifikuar, i mundshëm për t’u implementuar, me impakt të menjëhershëm në jetën e çdo banori dhe financiarisht i realizueshëm.

Pogradeci, shikohet mes Projektit Strategjik “mat” si pjesë integrale e një territori më të gjerë, sesa vetë territori i shtrirjes administrative, si pjesë e Euro-Rajonit, si një prej zonave më të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, me mundësi ë të shumta për zhvillimin e turizmit, agro-biznesit, hapësirës sipërmarrëse, artizanatit, peshkimit, industrisë së lehtë dhe ushqimore etj.

Falenderoj bashkëpunëtorët, konsulentët e mi dhe të gjithë ata që mes ideve të tyre dhe punës së përkushtuar, kontribuan në hartimin e Projektit tonë Strategjik.

BASHKË PËR POGRADECIN

Eduart Kapri